



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SHFRYTËZIM PYJESH”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

S2-IV-18

Tiranë, Tetor 2018

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	SHFRYTËZIM PYJESH			Kodi
Kohëzgjatja	1800-2100 orë	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	S2-IV-18
Qëllimi:	<p>Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Shfrytëzim pyjesh”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është <i>“zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar s teknik i mesëm në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me pyjet.”</i>. Zhvillimi te individi i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe një shkallë të gjerë njohurish profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në kualifikimin “Shfrytëzim pyjesh” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të individit që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë përfunduar kualifikimin profesional “Pyje”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. - Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucioni përgjegjës përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<ul style="list-style-type: none"> - Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shfrytëzim pyjesh”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajisë individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të aftësisimit profesional, Teknik për shfrytëzimin e pyjeve, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. - Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që kanë veprimtari për shfrytëzimin e pyjeve dhe përpunimin e lëndës drusore. - Me përfundimin e këtij niveli, individi fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare. 			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	S-III-02-12			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të mësuarit në:

NJOHURI

Bazat e sipërmarrjes dhe organizimi i punës

- Të shpjegojë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj;
- Të shpjegojë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes të punimeve pyjore dhe të shfrytëzimit të pyjeve;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në tregtimin e materialit drunor në pyll dhe tek konsumatori;
- Të përshkruajë parimet e përgjithshme të punësimit në punimet pyjore;
- Të përshkruajë disa nga normat e punës në operacionet e shfrytëzimit të pyjeve dhe punimeve ndihmëse, sipas librit përkatës;
- Të përshkruajë elementët kryesorë të organizimit të punës në brigadat komplekse të shfrytëzimit të pyjeve;
- Të përshkruajë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës në shfrytëzimin e pyjeve;
- Të përshkruajë llogaritjen normave të punës në shfrytëzimin e pyjeve, plotësimin e evidencave të kohës së punës, pagave dhe shpërblimeve të një brigade komplekse shfrytëzimi pyjesh;
- Të listojë parimet kryesore të Kodit të Punës;
- Të listojë elementët e një kontrate punësimi për kryerjen e punimeve në pyje;
- Të përshkruajë mënyrën e azhurnimit të një planin tekniko-organizativ të shfrytëzimit të ngastrës së pyjeve;
- Të përshkruajë mënyrën e vlerësimit të kostos produkteve të realizuara gjatë shfrytëzimit të ngastrës;
- Të listojë procedurat për kolaudim dhe dorëzim e ngastrave tek organet pyjore apo pronari i ngastrës;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;

Siguria dhe shëndeti në punë

- Të përshkruajë standardet kryesore të sigurisë dhe mbrojtjes në punë që zbatohen në Shqipëri dhe ato në BE;
- Të përshkruajë dispozitat ligjore për mbrojtjen në punë, rreziqet kryesore në procesin e shfrytëzimit të pyjeve;
- Të përshkruajë masat e sigurimit teknik dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale për të gjitha fazat e procesit teknologjik në shfrytëzimin e pyjeve dhe vjeljen e produkteve të tjera jo drusorë;
- Të përshkruajë pajisjet për mbrojtjen e kokës, duarve dhe këmbëve që përdoren gjatë shfrytëzimit të pyjeve;
- Të përshkruajë përgjegjësitë e punëmarrësit dhe ato të punëdhënësit për sigurinë dhe shëndetin gjatë kryerjes së punës efektive dhe jashtë saj;
- Të shpjegojë hapat e ndihmës së shpejtë që jepet në vendin e punës në shfrytëzimin e pyjeve;

- Të përshkruajë zjarret në pyje, masat parandaluese dhe sistemi i informimit dhe sinjalizimit;
- Të shpjegojë masat dhe veprimet që kryhen në rast zjarri në pyll apo në kantieret e shfrytëzimit të pyjeve;
- Të listojë rregullat e rrëzimit të drurëve apo rrokullisjes së asortimenteve drusore në pyll;

Legjislacioni dhe aktet rregullatore në trajtimin e pyjeve

- Të përshkruajë legjislacionin kryesor mbi pyjet, faunën, ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit;
- Të përshkruajë aktet nënligjore që rregullojnë shfrytëzimin e pyjeve dhe produkteve pyjore, jo drusorë si dhe sanksionet për dëmtimet në pyje dhe kullota;
- Të përshkruajë legjislacionin mbi ushtrimin e gjuetisë (kalendari i gjuetisë, afatet, llojet etj.);
- Të përshkruajë legjislacionin mbi pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në sektorin e shfrytëzimit të pyjeve;
- Të përshkruajë Kodin e Procedurave administrative për lidhjen e zbatimit e kontratave, marrëveshjet etj.;
- Të përshkruajë rregullat dhe kodin e etikës në punë;

Topogjeodezi

- Të përshkruajë elementet e hartës topografike në përgjithësi, hartat topografike e ato pyjore të planeve të mbarështimit të pyjeve;
- Të përshkruajë elementet kryesore të programeve kompjuterike të punimeve të hartave “GIS”;
- Të përshkruajë nevojën e përdorimit të aparatit GPS, për matje të koordinatave gjeografike dhe lartësisë mbi nivelin e detit;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të instrumenteve të thjeshtë matës të lartësisë së drurit, të gjatësive dhe pjerrësive në terren;

Silvoteknika

- Të shpjegojë qëllimin e Silvoteknikës, si pjesa teknike e Silvikulturës;
- Të listojë fazat e zhvillimit të pyllit duke përshkruar çdo etapë zhvillimi;
- Të përshkruajë teknikat e zbatimit të prerjeve kulturore në pyje;
- Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes të intensitetit të prerjeve kulturore në pyje;
- Të përshkruajë materialin drusor të dalë nga prerjet kulturore ;
- Të listojë format e qeverisjes së pyjeve dhe trajtimet për çdo formë qeverisje;
- Të listojë metodat e shndërrimit në pyje (konversioni);

Mbarështim pyjor

- Të shpjegojë parimet bazë të mbarështimit të qëndrueshëm dhe shumë funksional të pyjeve dhe elementët tekniko-ekonomik;
- Të përshkruajë shenjat kufitare të ekonomive pyjore, ngastrave dhe nën ngastrave pyjore;
- Të rendisin kriteret e ndarjes së ekonomisë pyjore në ngastra dhe nën ngastra pyjore;
- Të shpjegojë shfrytëzueshmërinë në pyje dhe format e saj;

- Të përshkruajë ciklin e prodhimit të grumbullit pyjor;
- Të shpjegojë përmbajtjen e një plani mbarështimi pyjesh për një Ekonomi Pyjore dhe planin 10 vjeçar të shfrytëzimeve dhe prerjeve kulturore.

Mbrritshmëria në ngastra dhe ekonomi pyjore

- Të përshkruajë parimet kryesore të organizimit dhe futjes në shfrytëzim të ngastrave pyjore;
- Të përshkruajë elementet kryesore të ngritjes së kantierëve dhe të vendstrehimeve të punonjësve dhe mjeteve;
- Të përshkruajë elementet kryesor dhe parametrat teknik të rrugëve auto-pyjore, mënyrat dhe mekanizmat kryesore për hapjen e tyre;
- Të përshkruajë instrumentet e thjeshta për piktimin e rrugëve auto-pyjore;
- Të përshkruajë nevojën e mirëmbajtjes dhe riparimit vjetore të rrugëve pyjore;
- Të përshkruajë masat e sigurisë për lëvizje dhe qarkullim në rrugët auto-pyjore;

Teknologjia e shfrytëzimit të pyjeve

- Të përshkruajë punimet përgatitore në fillimin e procesit të shfrytëzimit në një ngastër;
- Të përshkruajë fazat procesit teknologjik të shfrytëzimit të pyjeve;
- Të përshkruajë punimet përgatitore për prerjen dhe asortimin e lëndës drusore në pyll (pastrimi i ngastrës së shfrytëzimit nga mbetjet, drurët e thatë, drurët e varur, gurët e lëvizshëm dhe shkurret rreth drurëve të shënuar për t'u prerë, hapjen e rrugëve të lëvizjes së punëtorëve, kafshëve të ngarkesës dhe mekanizmave që nevojiten për transportin e brendshëm të lëndës drusore, ndërtimi i lugjeve, ndërtimi i skelave të ngarkimit dhe shesheve të depozitimit të drurit);

Fazat e procesit teknologjik në shfrytëzimin e pyjeve

Rrëzimi dhe përpunimi i parë i lëndës në pyll.

- Të përshkruajë teknikën e prerjes me motosharrë (rrëzimi) të drurit të shënuar (damkosur) përcaktimi i drejtimit të rrëzimit;
- Të përshkruajë veglat e mjetet e thjeshta që përdoren për rrëzimin e drurit;
- Të përshkruajë teknikën e procesin të prerjes së degëve anësore të trungut, si dhe veglat dhe mekanizmat që përdoren;
- Të përshkruajë teknikën e procesin të laspitjes (heqjes së lëvores), veglat dhe mekanizmat që përdoren;
- Të përshkruajë teknikën e procesin të asortimit të lëndës drusore, kriteret, veglat dhe mekanizmat që përdoren, vendin e asortimit (kjo në funksion të mënyrës dhe mekanizmave të transportit të brendshëm të lëndës drusore);
- Të përshkruajë standardet e asortimenteve kryesorë të lëndës drusore në plotësim të kërkesave të konsumatorit apo standardeve ndërkombëtare sipas kriterëve të cilësisë dhe përmasave.

Transporti i brendshëm me krah dhe mekanizma

- Të shpjegojë skemat teknologjike të transportit të brendshëm në ngastër;
- Të përshkruajë në mënyrë të përgjithshme procesin e transportit të brendshëm të lëndës drusore (mënyrat e transportit, llojet e mekanizmave që përdoren për transport);
- Të përshkruajë procesin e transportit të brendshëm me rrokullisje dhe rrëshqitje, si dhe veglat dhe mjetet që përdoren;

- Të përshkruajë parametrat kryesore të rrugëve të traktorit, të rrugëve të kafshëve, të rrugëve të rrëshqitjes e rrokullisjes, të skelave të ngarkimit dhe organizimin e shesheve të depozitimit të lëndës drusore;
- Të përshkruajë procesin e transportit të brendshëm me traktorë pyjor (transporti me zvarritje, gjysmë zvarritje, mbi platforma, etj.);
- Të përshkruajë procesin e transportit të brendshëm me moto-organo dhe rregullat përkatëse të sigurimit teknik;
- Të përshkruajë procesin e transportit të brendshëm me teleferik dhe rregullat përkatëse të sigurimit teknik;
- Të përshkruajë procesin e transportit të brendshëm me kafshë dhe mjetet përkatëse

Depozitimi, sistemimi, marketimi dhe shitja e lëndës drusore.

- Të përshkruajë mënyrën e sistemimit dhe stivimit të asortimenteve të lëndës drusore në sheshet e manipulimit apo skelat e ngarkimit;
- Të përshkruajë mënyrën e matjes, marketimit dhe llogaritjes së volumit të lëndës drusore sipas asortimenteve;
- Të përshkruajë humbjet gjatë procesit teknologjik të prodhimit dhe transportit të brendshëm të lëndës drusore;
- Të listojë rregullat e dorëzimit magazinimit dhe shitjes së materialit drusor nga pylli;
- Të përshkruajë mënyrat e ngarkimit të lëndës drusore me vegla dore apo me mekanizma;
- Të listojë mjetet e transportit të lëndës drusore nga vend depozitimi deri tek konsumatori;
- Të përshkruajë teknologjinë e prodhimit të qymyrit të drurit në pyll nga mbeturinat apo lënda drusore e pamundur për transport;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit të ngastrave pyjore e favorizimin e ripërtëritjes natyrore;
- Të listojë rregullat e kolaudimit dhe dorëzimit të ngastrave pyjore;

Mekanizmat kryesore të shfrytëzimit të pyjeve në vendit tonë

Motosharrat (tipet kryesore që përdoren në vendin tonë).

- Të përshkruajë sistemet kryesore të motosharrës (sistemi i ndezjes, sistemi i ushqimit, sistemi i lubrifikimit, sistemi i prerjes, etj.);
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së motosharrës për punë (lëndës djegëse, lëvizjet në pyll dhe jashtë tij);
- Të përshkruajë defektet kryesore të motosharrave dhe mënyrën e riparimit të tyre (ndërimi i pjesëve të dëmtuara,..... etj.);
- Të listojë pajisjet e veshjet e domosdoshme gjatë punës në faza të ndryshme të procesit teknologjik;
- Të përshkruajë teknikat e punës me motosharrë në të gjitha operacionet teknologjike të shfrytëzimit të pyjeve;

Traktorët pyjor, (tipet kryesore, terrenet ku përdoren)

- Të përshkruajë tipet kryesore të traktorëve pyjor dhe terrenet ku përdoren;
- Të përshkruajë sistemet kryesore të traktorëve pyjor, mjetet ndihmese;
- Të përshkruajë teknikën e realizimit të transportin me traktor;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë transportit me traktor;

Motorganot dhe teleferikët pyjor me një litar mbajtës (transport me zvarritje dhe transport ajror i lëndës drusore)

- Të përshkruajë sistemet e motorëve me katër kohë, për motorgonot dhe teleferikët e palëvizshëm (me një litar mbajtës të ankoruar në dy pika);
- Të përshkruajë sistemin e transmetimit të lëvizjes dhe frenimit të teleferikëve;
- Të përshkruajë llojet e litarëve të çelikut, karakteristikat e tyre, mënyrën e manipulimit dhe bashkimit të tyre (qepja);
- Të përshkruajë veprimet dhe proceset e punës në instalimin dhe montimin e një teleferiku të tipit me një litar mbajtës dhe një litar tërheqës;
- Të përshkruajë teknikën e manovrimit të punës në teleferik;
- Të përshkruajë mënyrën dhe teknikën e ngritjes dhe përgatitjen e kavaletave në pyll;
- Të interpretojë projektin për prerje dhe pastrimin e trasesë;
- Të përshkruajë mënyrën e vënies në punë dhe kryerjen e provave teknike të punës së teleferikut;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të zbritësit të thjeshtë për material drusore të imët dhe pajisjet ndihmëse;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë, në të gjitha proceset e montimit dhe të transportit me motorgono dhe teleferik dhe nevojën e përdorimit të tabelave paralajmëruese gjatë punës gjatë transportit;

“Makinat kombinat” (njohuri të përgjithshme)

- Të përshkruajë klasifikimin e Makinave kombinat dhe mundësitë e përdorimit të tyre në vendin tonë;
- Të përshkruajë makinat rrëzues-asortues (Feller);
- Të përshkruajë makinat, rrëzuese-heqje degësh-asortues (Harvester);
- Të përshkruajë makinat copëtuese (grirëse) të lëndës drusore në pyll;

Produktet pyjore jo drusore me kryesore (ppjd)

- Të përshkruajë produktet pyjore jo drusore, llojet kryesore dhe klasifikimi i tyre;
- Të përshkruajë florën kryesore mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore, që grumbullohen nga fondi pyjor e kullosor;
- Të përshkruajë rregullat teknike dhe mjetet që përdorën në vjeljen e produkteve pyjore jo drusore, të kërpudhave produktet kryesore që përfitohen nga distilimi i gjetheve dhe halave të florës së pyllit (rrëshirat, esencat e vajrat eterike.....);
- Të listojë llojet kryesore të kërpudhave që grumbullohen dhe klasifikimi i tyre;
- Të përshkruajë teknikat e grumbullimit dhe përpunimit të kërpudhave në pyll;
- Të përshkruajë teknika të prerjes dhe grumbullimit të thuprës, si dhe mënyrën e trajtimit të shelgjishteve natyrore, si lëndë e parë për prodhim thupre;
- Të përshkruajë mënyrën e nxjerrjes së rrënjëve të shqopës dhe maresë, teknika e nxjerrjes dhe përpunimit të tyre në pyll;
- Të përshkruajë llojet e shkurreve të gjelbra, trajtimi i tyre dhe teknikat e prerjes së degëzave zbukuruese;
- Të përshkruajë mënyrat kryesore të vlerësimit të mbetjeve në pyll;
- Të përshkruajë mënyrën e prodhimit të qymyrit dhe eshkës së drurit;
- Të përshkruajë florën pyjore që prodhojnë fruta dhe fara objekt grumbullimi, si dhe teknikat dhe mjetet kryesore që përdoren për vjeljen e tyre;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Bazat e sipërmarrjes dhe organizimi i punës

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës të punimeve pyjore dhe shfrytëzimit të pyjeve;
- Të plotësojë dokumentacionin e lëvizjes së mallrave, shërbimeve dhe veprimeve kryesore me bankën;
- Të plotësojë regjistra të ditëve të punës, pagesave dhe të normimit të punës në shfrytëzimin e pyjeve, në tre fazat e procesit teknologjik;
- Të plotësojë pasqyrat e azhurnimit të planit tekniko-ekonomik të shfrytëzimit të ngastrës;
- Të realizojë organizimin e punës në skuadrat komplekse të shfrytëzimit të pyjeve;
- Të realizojë llogaritje të thjeshta ekonomike, të kostove deri në rrugë auto, të asortimenteve në shfrytëzimin e pyjeve;
- Të përcaktojë, numrin e punëtoreve, mekanizmave dhe periudhën e shfrytëzimit, mbështetur tek Plani Tekniko-Ekonomik i shfrytëzimit të ngastrës;
- Të kryejë kolaudimin dhe dorëzimin e ngastrave tek organet pyjore apo pronari i ngastrës pas realizimit të shfrytëzimeve;

Siguria dhe shëndeti në punë

- Të zbatojë dispozitat ligjore për mbrojtjen në punë, për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësi të tjera natyrore;
- Të kryejë periodikisht kontrollin vjetor mjekësor të përcaktuar;
- Të përgatisë dhe të vendosë në vend të dukshme tabelat paralajmëruese të veprimtarive të ndaluara dhe rreziqeve që mund të ketë gjatë punimeve në shfrytëzimin e pyjeve;
- Të përgatisë dhe të mirëmbajë Këndet e MNZ;
- Të marrë masa sigurie për ruajtjen e karburanteve, mekanizmave dhe ngrehinave;
- Të zbatojë të gjitha masat e sigurimit teknik dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale të duarve, kokës dhe këmbëve, gjatë gjitha fazave të procesit teknologjik në shfrytëzimin e pyjeve dhe vjeljen e produkteve të tjera jo drusorë;
- Të zbatojë përgjegjësitë si punëmarrës për sigurinë dhe shëndetin gjatë kryerjes së punës efektive dhe jashtë saj;
- Të zbatojë masat e sigurisë për lëvizje dhe qarkullim në rrugët auto pyjore;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti gjatë shfrytëzimit të pyjeve;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së pyjeve nga zjarri;

Legjislacioni dhe aktet rregullatore në trajtimin e pyjeve

- Të zbatojnë kërkesat teknike të Rregulloreve në shfrytëzimin e pyjeve dhe produkteve pyjore, jo drusorë;
- Të zbatojnë kërkesat e legjislacionit mbi pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për sektorin shfrytëzimit të pyjeve;
- Të zbatojnë Kodin e Procedurave administrative për zbatimin e kontratave, marrëveshjet, Kodin e punës, etj.;
- Të zbatojnë rregullat dhe kodin e etikës në punë;

Topogjeodezi

- Të kryejë matje me instrumente të thjeshtë matës gjeodezie;

- Të përcaktojë metodat e nivelimeve dhe instrumentet përkatës që përdoren;
- Të kryejë matje të sipërfaqeve pyjore dhe jo pyjore me teodolit dhe nivelues;
- Të plotësojë tabelat e nivelimit dhe të matjeve me teodolit,;
- Të lexojë latën në pikat e poligonit;
- Të realizojë trashimin e vijave me pjerrësi të caktuar në terren;
- Të përdorë instrumentet kryesore në punime topografike;

Silvoteknika

- Të përcaktojë llojin e prerjeve kulturore në varësi të fazës së zhvillimit të pyjeve;
- Të përcaktojë drurët që do të hiqen gjatë prerjeve kulturore;
- Të vlerësojë materialin drusor të dalë nga prerjet kulturore;
- Të llogarisë intensitetin dhe periodicitetin e prerjeve kulturore;
- Të përdorë të gjitha mjetet dhe mekanizmat gjatë kryerjes së prerjeve kulturore si dhe punimeve të tjera në ngastrat pyjore;

Mbarështim pyjor

- Të përcaktojë kriteret e ndarjes së ekonomisë pyjore në ngastra dhe nën ngastra;
- Të vendosin shenjat kufitare sipas pronësisë së pyjeve;
- Të plotësojë formularët e përshkrimit parcellar;
- Të përdorë instrumentet dentrometrik për matjen e diametrit dhe të lartësisë së drurit në këmbë;
- Të kryejë matje dhe llogaritje të volumit të asortimenteve drusor duke përdorur tabela të llogaritjes së asortimenteve dhe formulat e llogaritjes përkatëse;
- Të kryejë shënimin (damkosjen) e drurëve që do priten duke përdorur veglat e duhura;
- Të plotësojë listë damkën në terren;
- Të plotësojë dhe llogarisë volume të lëndës drusore të damkosur (listë damkën e zyrës);
- Të plotësojë evidencat të punimeve të kryera gjatë zbatimit të planeve të mbarështimit;
- Të zbatojë metodat e matjes në pyje në varësi të formës së qeverisjes;
- Të nxjerrin të dhëna nga planet e mbarështimit

Mbrirshmeria në ngastra dhe ekonomitë pyjore

- Të zbatojë parimet kryesore të organizimit dhe futjes në shfrytëzim të ngastrave pyjore;
- Të zbatojë elementet kryesorë të ngritjes së kantierëve dhe të vendstrehimeve të punonjësve dhe mjeteve;
- Të zbatojë projektin me elementet kryesor dhe parametrat teknik të rrugëve auto-pyjore;
- Të realizojë me instrumentet e thjeshta piketimin e rrugëve auto-pyjore dytësore;
- Të ndërtojë dhe mirëmbajë urat prej druri, rrugët e lëvizjes së kafshëve dhe traktorëve, etj.;
- Të vendosë shenjat e tabelat përkatëse paralajmëruese;

Teknologjia e shfrytëzimit të pyjeve

- Të zbatojë skemat teknologjike të shfrytëzimit të pyjeve sipas Planit Tekniko-Ekonomik të miratuar për shfrytëzimin e ngastrës;

- Të damkosë drurët për shfrytëzim;
- Të përcaktojë drejtimin e rrëzimit të drurëve në pyll;
- Të kryejë punimet përgatitore për prerjen dhe asortimin e lëndës drusore në pyll (pastrimi i ngastrës së shfrytëzimit nga mbeturinat, drurët e thatë, drurët e varur, gurët e lëvizshëm dhe shkurret rreth drurëve të shënuar për tu prerë;
- Të hapë rrugët e lëvizjes së punëtorëve, kafshëve të ngarkesës dhe mekanizmave që nevojiten për transportin e brendshëm të lëndës drusore, ndërtimin e skelave të ngarkimit dhe shesheve të depozitimit të drurit;
- Të përdorë veglat e krahut që përdoren në shfrytëzimin e pyjeve, prerje, transport, stivim dhe ngarkim;
- Të kryejë prerjen e drurit të shënuar (damkosur) për t'u prerë duke paracaktuar drejtimin e rrëzimit;
- Të kryejë procesin e prerjes së degëve anësore të trungut duke përdorur veglat dhe mekanizmat e duhura;
- Të kryejë procesin e laspitjes (heqjes së lëvores) duke përdorur veglat dhe mekanizmat e duhura;
- Të kryejë procesin e asortimit të lëndës drusore duke përdorur veglat dhe mekanizmat e duhura në përshtatje me vendin e abortimit, në funksion të mënyrës dhe mekanizmave të transportit të brendshëm të lëndës drusore;
- Të selekcionojë asortimentet kryesorë të lëndës drusore sipas standardeve përkatëse (trupa rimeso-kompesatoje, trupa traverse, trupa për lëndë të sharruar, lëndë ndërtimi, shtylla miniere, degë voze bishta, dru letre, dru zjarri etj.);
- Të kryejë procesin e transportit të brendshëm të lëndës drusore duke përdorur llojet e përshtatshme të mekanizmave për transport;
- Të kryejë procesin e transportit të brendshëm me rrokullisje dhe rrëshqitje duke përdorur veglat dhe mjetet përkatës;
- Të kryejë sistemimin dhe stivimin e asortimenteve të lëndës drusore në sheshet e manipulimit apo skelat e ngarkimit;
- Të kryejë matje, marketim dhe llogaritje të volumit të lëndës drusore sipas asortimenteve;
- Të llogarisë humbjet gjatë procesit teknologjik të prodhimit dhe transportit të brendshëm të lëndës drusore;
- Të kryejë ngarkimin e lëndës drusore me vegla dore apo me mekanizma;
- Të përdorë mjetet e transportit të lëndës drusore nga vend depozitimi deri tek konsumatori;
- Të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm në dorëzimin apo shitjen e lëndës drusore;

Mekanizmat kryesore të shfrytëzimit të pyjeve

- Të përgatisë motosharrën për punë (lëndën djegëse, zinxhirin, etj.);
- Të riparojë defekte të thjeshta të motosharrave në pyll (ndërrimi i pjesëve të dëmtuara etj.);
- Të përdorë motosharrën në gjitha operacionet teknologjike të shfrytëzimit të pyjeve (rrëzim, heqje degësh, asortim);
- Të përdorë instrumentet dhe makineritë për rrëzimin e drurit;
- Të përdorë tipet e sëpatave duke i mprehur dhe mirëmbajtur ato;
- Të kryejë procesin e transportit të brendshëm me traktorë pyjor (transporti me zvarritje, gjysmë zvarritje, mbi platforma etj.);

- Të kryejë procesin e transportit të brendshëm me kafshë;
- Të kryejë punimet përgatitore për hapje traseje, vendosje të motorgonove, shtrirje të litarëve mbajtës, ndërtim kavaletash deri në montim të teleferikut në pyll;
- Të kryejë procesin e lidhjes e ngarkimit të lëndës drusore në transportin e brendshëm me motor-gono;
- Të kryejë procesin e lidhjes, ngarkimit dhe shkarkimit të lëndës drusore në procesin e transportit të brendshëm me teleferik.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.